



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:059717

Datë: 06.06.2024

Numri i dokumentit: 05792694

KPPP.nr.588/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit “A+ Elektrik” SH.P.K., me NUI: 811549627, me seli në rr. “Muharrem Fejza” Obj 1, Lok.1-1, në Prishtinë, kundër debitorit “Devolli Corporation” SH.P.K., me seli në rr. “Zahir Pajaziti”, në Pejë, me NUI: 810407454, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.200/23 të datës 27.03.2023, të Përmbartuesit Privat Gëzim Gjoshi, me seli në Gjakovë, jashtë seancës, me datë 06.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Devolli Corporation” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.200/23 i datës 27.03.2023, i Përmbartuesit Privat Gëzim Gjoshi.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.200/23 i datës 27.03.2023 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Gëzim Gjoshi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “A+ Elektrik” SH.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.200/23 të datës 27.03.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës Nr. 04/2022 të datës 10.03.2022; Faturës Nr. 09/2022 të datës 11.05.2022; Faturës Nr. 10/2022 të datës 11.05.2022; Faturës Nr. 11/2022 të datës 11.05.2022; Faturës Nr. 12/2022 të datës 11.05.2022 dhe Faturës Nr. 02/2023 të datës 09.01.2023; me të cilën është detyruar debitori që në emër të përmbartjes së obligimeve

të papaguara nga faturat e lartcekura, brenda afatit 7 ditor nga dita e dorëzimit të urdhrit, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 5,359.90 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data kur kredia është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të propozimit, ashtuqë të gjitha detyrimet të realizohen përmes zbatimit të përbarimit sipas llogarive bankare dhe bartjen e tyre në llogari të veçantë bankare të përbaruesit privat, si dhe përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar prapësimin e debitorit, duke theksuar se faturat nr. 12/2022 dhe nr. 02/23, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për t'u konsideruar dokument i besueshëm, pasi që kredia nuk është bërë e kërkueshme dhe si të tilla nuk përmbajnë të dhëna mbi kohën e përmbushjes së detyrimit monetar. Më tutje ka shtuar se me kreditorin tash e një kohë janë marrëdhënie bashkëpunimi të furnizimit lidhur me artikuj të caktuar, ku debitori vazhdimisht ka realizuar pagesat e faturave në afat, pasi që ato janë bërë të kërkueshme nga ana e debitorit. Në fund ka theksuar se me asnjë provë nuk vërtetohet fakti se debitorit i është caktuar nga kreditori afati i përmbushjes së obligimit dhe se kreditori ka rënë në vonesë, andaj debitori nuk obligohet në asnjë lloj kamate lidhur me këtë çështje. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri përbarimor dhe të anulohen të gjitha veprimet e kryera në këtë procedurë.

Kreditori në përgjigje në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke deklaruar se i ka bashkëngjitur gjykatës si provë deklaratën mbi kërkueshmërinë e kredisë, ku nuk qëndron kundërshtimi i debitorit, ndërsa në lidhje me kundërshtimin e debitorit rreth kamatës ka theksuar se përderisa nuk paguhet obligimi duhen paguhen edhe kamatat. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri përbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbnim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbnim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbnimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbnim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbnim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbnimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbnuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm: Faturën Nr. 04/2022 të datës 10.03.2022; Faturën Nr. 09/2022 të datës 11.05.2022; Faturën Nr. 10/2022 të datës 11.05.2022; Faturën Nr. 11/2022 të datës 11.05.2022; Faturën Nr. 12/2022 të datës 11.05.2022 dhe Faturën Nr. 02/2023 të datës 09.01.2023; të cilat fatura i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave, është përcaktuar shuma e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, koha e përmbushjes së këtij detyrimi si dhe të njëjtat janë bërë të arritshme për pagesë.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbnimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, si dhe mbajnë nënshkrimin e pranimit nga debitori, ndërsa Fatura Nr. 04/2022 të datës 10.03.2022 edhe pse nuk përmban nënshkrimin e pranimit nga ana e debitorit, rezulton se e njëjta është pranuar nga debitori dhe është pagesë e pjesërishtme për detyrimin sipas kësaj fature, si dhe nuk e njëjta është kontestuar në asnjë formë.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit për kohën e përmbushjes së detyrimit monetar për faturën nr. 12/2022 të datës 11.05.2022 dhe faturën nr. 02/2023 të datës 09.01.2023 dhe gjeti

se një pretendim i tillë nuk gjeen mbështetje ligjore, sepse në rastin konkret këto fatura i plotësojnë kushtet e përcaktuara për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, për faktin se afati i përmbushjes së detyrimit është përcaktuar në faturë. Për më tepër fatura e cila nuk përmban afat të përmbushjes nga data e lëshimit të faturës, nënkuptohet se afati për përmbushje arrin menjëherë respektivisht në datën e lëshimit të faturës.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.588/23, datë 06.06.2024.

Gjyqtari  
Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.